



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO  
**GJYKATA KUSHTETUESE**  
**УСТАВНИ СУД**  
**CONSTITUTIONAL COURT**

---

Prishtinë, më 17 korrik 2012  
Nr. ref.: AGJ/282/12

## **AKTGJYKIM**

në

**Rastin Nr. KI129/11**

Parashtruesi

**Viktor Marku**

**Vlerësim i kushtetutshmërisë së mosekzekutimit të Aktvendimit të Gjykatës së Qarkut në Pejë Ac. nr. 158/2011 të 5 korrikut 2011 dhe vendimit nr. 02/197/2010 të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës të Republikës së Kosovës nga ana e Komunës së Klinës**

### **GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS**

e përbërë nga:

Enver Hasani, Kryetar  
Kadri Kryeziu, Zëvendëskryetar  
Robert Carolan, gjyqtar  
Altay Suroy, gjyqtar  
Almira Rodrigues, gjyqtar  
Snezhana Botusharova, gjyqtare dhe  
Ivan Čukalović, gjyqtar

#### **Parashtruesi i kërkesës**

1. Parashtruesi i kërkesës është z. Viktor Marku, me vendbanim në Fshatin Videjë, Komuna e Klinës.

## **Vendimi i kontestuar**

2. Parashtruesi i kërkesës konteston mosekzekutimin e Vendimit Administrativ nr. 02/197/2010 të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (me tutje: KPMSHCK) dhe Aktvendimit Ac. nr. 158/2011 të Gjykatës së Qarkut në Pejë, të 5 korrikut 2011, nga ana e autoriteteve të Komunës së Klinës.

## **Objekti i çështjes**

3. Objekti i çështjes së Kërkesës, është vlerësimi nga Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: "Gjykata"), i kushtetutshmërisë së mosekzekutimit të Vendimit administrativ nr. 02/197/2010 të KPMSHCK dhe Aktvendimit të Gjykatës së Qarkut në Pejë, Ac. nr. 158/2011 të 5 korrikut 2011, që kanë të bëjnë me kthimin e parashtruesit në vendin e punës, pasi që të gjitha vendimet janë në favorin e tij.

## **Baza juridike**

4. Neni 113.7 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta), neni 47 i Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, i 15 janarit 2009 (në tekstin e mëtejme: "Ligji") dhe rregulli 28 i Rregullores së punës të Gjykatës (në tekstin e mëtejme: "Rregullorja").

## **Procedura në gjykatë**

5. Më 10 tetor 2011 parashtruesi e dorëzoi Kërkesën në Gjykatë.
6. Më 15 tetor 2011, Kryetari, me vendimin Nr. GJR. 129/11, caktoi gjyqtarin Altay Suroy Gjyqtar Raportues. Po të njëjtën ditë, me vendimin Nr. KSH. 127/11, caktoi Kolegjin Shqyrtues në përbërje të gjyqtarëve: Snezhana Botusharova (kryesuese), Prof. dr. Enver Hasani (anëtar) dhe 3. Dr. Iliriana Islami (anëtare).
7. Më 18 janar 2012, Sekretari i Përgjithshëm i Gjykatës Kushtetuese ka njoftuar parashtruesin e kërkesës, Komunën e Klinës dhe palët e përfshira në procedurë.
8. Më 2 korrik 2012, Kryetari Nr. KSH. 129/11, caktoi Kolegjin e ri Shqyrtues në përbërje të gjyqtarëve: 1. Snezhana Botusharova (kryesuese) 2. Mr. sc. Kadri Kryeziu (anëtar) që e zëvendëson gjyqtaren Ilirian Islami, meqë mandati i saj si gjyqtare në Gjykatë i përfundoi më 26 qershor 2012, dhe Prof. dr. Enver Hasani (anëtar).
9. Më 11 korrik 2012, Gjykata shqyrtoi dhe votoi për rastin.

## **Përmbledhja e fakteve të procedurës administrative**

10. Parashtruesi e kërkesës, nga 2 maj 2000 ka punuar si punëtor social në Qendrën për Punë Sociale në Klinë (me tutje: QPS në Klinë) në cilësinë e shërbyesit civil me nr. id MPMS 122 deri në ndërprerjen e kontratës së punës. Sipas vërtetimit Nr. 0634/09 te 19 majit 2009, të QPS në Klinë, parashtruesi ka pas kontrate pune deri më 31 dhjetor 2009, me mundësi vazhdimi.
11. Më 16 dhjetor 2009, Drejtoria për Administratë dhe personel përmes shkresës nr. 02-118-1767/09 njoftoi parashtruesin për ndërprerjen e marrëdhënies së punës, siç thuhet për shkak të skadimit të kontratës së punës dhe vlerësimit negativ të detyrave të punës dhe se parashtruesi nga 31 dhjetori 2009 nuk është i obliguar të lajmërohet në vendin e punës.

12. Më 28 dhjetor 2009, Drejtoria për Administratë dhe personel, nxori aktvendimin me nr. 02-118-4833/09 për përfundimin e marrëdhënies së punës për shkak të skadimit të kontratës së punës dhe vlerësimit negativ të detyrave të punës. Kundër këtij aktvendimi parashtruesi në afat ligjor ka parashtruar ankesë në Komisionin Komunal për Ankesa.
13. Më 5 janar 2010, Drejtoria e Administratës përmes konkluzionit Nr. 112-141/2010, shfuqizoi në tërësi Aktvendimin 02 nr. 118-4833/09 dhe mori vendim që parashtruesit t'i vazhdohet punësimi sipas kushteve të përcaktuara në kontratën e punës. Më pas, Drejtoria e Administratës dhe Personelit lëshoi vendim për vazhdimin e kontratës së punës (nr. i kontratës 02/112-291/10, posti 184) për parashtruesin e kërkesës në kohëzgjatje prej 6 muajsh, duke filluar nga 1 janari 2010 deri më 30 qershor 2010.
14. Më 14 maj 2010, Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale (me tutje: DDSHMS), përmes shkresës 02 nr. 118-1641/10 njoftoi parashtruesin për ndërprerjen e kontratës së punës për shkak të skadimit të kontratës së punës dhe vërejtjeve me shkrim të shqiptuara më parë. Kundër këtij njoftimi parashtruesi parashtrroi ankesë në Komisionin Komunal për Ankesa në Klinikë. DDSHMS, më 30 qershor 2010 nxori aktvendimin 02 nr. 118-2196/10 për përfundimin e punësimit në shërbimin civil për shkak të skadimit të kontratës së punës dhe vlerësimit negativ të detyrave të punës. Kundër këtij aktvendimi parashtruesi serish në afat ligjor parashtrroi ankesë në Komisionin Komunal për Ankesa në Klinikë.
15. Më 28 korrik 2010, Komisioni Komunal për Ankesa në Klinikë, nxori vendimin nr. 01 nr. 118-2815/2010 dhe refuzoi në tërësi ankesën e parashtruesit si të pa bazë, vërtetoi vendimin e Zyrës së Personelit 02 nr. 118-2196/10 të 30 qershorit 2010, me arsyetimin se parashtruesi nuk i është përmbajtur orarit të punës gjë të cilën e ka vërtetuar vërejtja disiplinore që i është shqiptuar atij me vendimin 02 nr. 132-1553/10, të 5 majit 2010, lëshur nga DSHMS në Klinikë.
16. Me 12 gusht 2010, parashtruesi ka parashtruar ankesë në KPMSHCK kundër vendimit të Komisionit Komunal për Ankesa në Klinikë duke kërkuar nga KPMSHCK që ta obligojë organin e punësimit që të rishqyrtojë rastin dhe t'ia vazhdojë kontratën e punës dhe ta kthejë në marrëdhënie pune në pajtim me kontratën e punës si Nëpunës për Asistencë Sociale në QPS në Klinikë dhe kompensimin e të ardhurave personale të humbura nga 1 korriku 2010, për shkak të ndërprerjes së kontratës së punës.
17. Kundër ankesës së parashtruesit, Zyra e personelit e KK në Klinikë, më 31 gusht 2010 ka bërë kundërshtim në KPMSHCK dhe ka kërkuar mbetjen në fuqi të vendimit 02 nr. 118-2196/10 të 30 qershorit 2010, si dhe vendimit 01 nr. 118-2815/2010 të 28 korrikut 2010 të Komisioni Komunal për Ankesa në Klinikë.
18. Më 8 tetor 2010, KPMSHCK, bazuar në shkresat e lëndës dhe aktet ligjore në fuqi, nxori Vendimin me nr. 02/197/2010 dhe aprovoi si të bazuar ankesën e parashtruesit të kërkesës nr. 1637/2010, anuloi: aktvendimin 02 nr. 118-2196/10 të 30 qershorit 2010, për përfundimin e punësimit në shërbimin civil, njoftimin e drejtorit të Drejtorisë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale 02 nr. 118-1641/10 të 14 majit 2010 për ndërprerjen e kontratës së punës dhe vendimin e Komisionit Komunal për Ankesa në Klinikë 01 nr. 118-2815/2010 të 28 korrikut 2010. Me këtë vendim KPMSHCK ka obliguar organin e punësimit që në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të vendimit ta kthejë parashtruesin në vendin e punës Nëpunës i Asistencës Sociale dhe t'ia lëshojë kontratën e punës në pajtim me nenin 4 të Udhëzimit Administrativ nr. MSH/DASHC 2003/02 dhe t'ia bëjë kompensimin e të ardhurave personale sipas pagës së caktuar me kontratë (paga e caktuar bruto 196.90 euro) në mënyrë retroaktive, që nga dita kur parashtruesit i është ndërprerë marrëdhënia e punës deri në ditën e ekzekutimit të këtij vendimi. Këshilla juridike e KPMSHCK citon: "Vendimi i Këshillit paraqet vendim

administrativ të formës së prerë, që i nënshtrohet shqyrtimit gjyqësor në përputhje me ligjin, ndërsa ankuesi në kuptim të realizimit të drejtave të veta mund t'i drejtohet gjykatës kompetente”.

19. Pas vendimit të KPMSHCK, parashtruesi i është drejtuar disa herë institucionit të punësimit Komunës së Klinës, Kryetarit të kësaj Komune dhe DDSHMS në Klinë. Mirëpo, siç duket, Komuna e Klinës nuk ka ndërmarrë asnjë veprim për ta zbatuar vendimin në fjalë.
20. Më 29 tetor 2010, parashtruesi njoftoi KPMSHCK se vendimi 02/197/2010 i 8 tetorit 2010 i aprovuar nga ky organ nuk po zbatohet nga personat përgjegjës të Komunës dhe kërkoi nga KPMSHCK që lidhur me këtë çështje të njoftohet Kryeministri dhe Kuvendi i Republikës së Kosovës, siç parashihet me ligj.
21. Më 3 nëntor 2010, KPMSHCK me kërkesën e parashtruesit dhe në pajtim me nenin 101.2 të Kushtetutës, si dhe nenin 15 paragrafi 1, 2 dhe 3 të Ligjit Nr 03/L-192 për KPMSHCK i është drejtuar Kryeministrit të Republikës së Kosovës dhe e ka njoftuar lidhur me moszbatimin e vendimeve të këtij organi. KPMSHCK duke u bazuar në nenin 15.1 të Ligjit Nr 03/L-192 citon: *“moszbatimi vendimit të Këshillit nga personi përgjegjës i institucionit paraqet shkelje të rëndë të detyrave të punës”*, më tej paragrafi 2 i nenit 15 përcakton: *“nëse personi përgjegjës nuk e ekzekuton vendimin e Këshillit në afat prej 15 ditësh, atëherë, Këshilli 15 ditë pas kalimit të këtij afati për ekzekutim, në pajtim me nenin 13 të Ligjit Nr 03/L-192 njoftohet Kryeministri i Republikës së Kosovës”*. Njoftimi nga paragrafi 2 i këtij neni *“konsiderohet kërkesë për fillimin e procedurës disiplinore dhe materiale kundër personit përgjegjës për ekzekutim e cila zhvillohet në pajtim me dispozitat e parapara me ligjin për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës”*.
22. Më 10 maj 2011, parashtruesi i është drejtuar Kryetarit të Kuvendit të Republikës së Kosovës z. Jakup Krasniqi dhe ka kërkuar nga ai që ta shtrijë autoritetin e tij brenda kompetencave të ngarkuara si Kryetari i Kuvendit të Republikës së Kosovës që të respektohet dhe zbatohet vendimi i KPMSHCK nga përgjegjësit e institucionit të punësimit për kthimin e tij në vendin e punës.

### **Përmbledhja e fakteve në procedurë gjyqësore**

23. Parashtruesi i kërkesës pasi që kishte shterur të gjitha mjetet juridike në procedurë administrative kishte bërë propozim për ekzekutimin e vendimit të KPMSHCK, sipas procedurës përmbarimore në Gjykatën Komunale në Klinë.
24. Më 18 nëntor 2010, Gjykata Komunale në Klinë, aprovoi propozimin e parashtruesit dhe nxori aktvendimin E. nr. 635/2010, për përmbarimin e vendimit të KPMSHCK, obligoi debitorin, përkatësisht organet kompetente të Kuvendit Komunal të Klinës, Kryetarin e Komunës, drejtorin e DAP-it për SHMS të KK Klinë që të ndërmarrin të gjitha veprimet për kthimin e parashtruesit në vendin e punës me të gjitha të drejtat e plota që dalin nga marrëdhënia e punës. Kjo gjykatë thekson se vendimi i KPMSHCK është vendim administrativ i formës së prerë dhe përmbarimor dhe nisur nga ky fakt është dashur që vendimi të ekzekutohet nga zyrtarët ose personat përgjegjës të KK-Klinë, në pajtim me kërkesat e nenit 14 të Ligjit Nr 03/L-192 për KPMSHCK.
25. Me 7 shkurt 2011, Komuna e Klinës, në cilësinë e debitorit, ushtroi kundërshtim kundër aktvendimit E. nr. 635/2010 të 18 nëntorit 2010 të Gjykatës Komunale në Klinë dhe propozoi që të anulohet ky vendim.

26. Më 7 prill 2011, Gjykata Komunale në Klinë, refuzoi si të pabazuar kundërshtimin e ushtruar nga debitori Komuna e Klinës, ndaj aktvendimit E. nr. 635/2010, për lejimin e përmbarimit. Komuna e Klinës e pa kënaqur me vendimin e lartpërmendur ushtroi ankesë në Gjykatën e Qarkut në Pejë.
27. Më 5 korrik 2011, Gjykata e Qarkut në Pejë, sipas ankesës së ushtruar nga debitori Komuna e Klinës nxori aktvendimin me Nr. Ac. nr. 158/2011 dhe hodhi poshtë si të pabazuar ankesën e së njëjtës, duke vërtetuar kështu aktvendimin e shkallës së parë E. nr. 635/2010 të 7 prillit 2011. Arsyetimin e vetë gjykata e kishte mbështetur në faktin se: *“vendimi KPMSHCK paraqet vendim administrativ të formës së prerë dhe si i tillë përben titull ekzekutiv dhe është në pajtim me nenin 24.1 (b) dhe 26.3 të Ligjit për Procedurën Përmbarimore dhe se inicimi i konfliktit administrativ në Gjykatën Supreme nga Komuna e Klinës nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi”*.

### **Pretendimet e parashtruesit të kërkesës**

28. Parashtruesi i kërkesës pretendon se, me moszbatimin e vendimeve gjyqësorë nga institucioni i punësimit, Komuna e Klinës, i janë shkelur të drejtat kushtetuese të garantuara me: Nenin 3 paragrafi 2 [Barazia para Ligjit], Nenin 7 paragrafi 1 [Vlerat], Nenin 21 paragrafi 1 dhe 3 [Parimet e Përgjithshme], Nenin 22 paragrafi 1 [Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut], Nenin 22 paragrafi 2 [Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive të Njeriut], Nenin 23 [Dinjiteti i Njeriut], Nenin 24.2 [Barazia para Ligjit] dhe Nenin 49 paragrafi 1 [E Drejta e Punës dhe ushtrimit të Profesionit].
29. Parashtruesi shpreh shqetësimin e tij lidhur me faktin që Komuna e Klinës nuk e zbatoi fillimisht vendimin e Këshillit, më pas vendimin e Gjykatës Komunale të Klinës dhe se fundmi vendimin e Gjykatës së Qarkut në Pejë. Mirëpo edhe Qeveria (ekzekutivi), që është kompetente për të siguruar mekanizma për zbatimin e ligjit dhe vendimeve gjyqësore, sipas parashtruesit nuk ndërmori asnjë veprim lidhur me këtë çështje.

### **Dispozitat relevante ligjore lidhur me procedurat e ekzekutimit të vendimeve administrative dhe gjyqësore**

#### **Ligji për Procedurën Përmbarimore (Nr. 03/L-008)**

30. Në Republikën e Kosovës, rregullat ligjore, procedurat e ekzekutimit dhe siguria e vendimeve rregullohen me Ligjin për Procedurën Përmbarimore [Ligji Nr. 03/L-008].

#### *Neni 1 [Përmbajtja e ligjit]*

1.1 *Me këtë ligj caktohen rregullat për procedurën e gjykatës sipas të cilës realizohen kërkesat në bazë të titujve ekzekutiv (procedura e përmbarimit), po qe se me ligj të posaçëm nuk është paraparë diçka tjetër.*

1.2 *Dispozitat e këtij ligji zbatohen edhe për përmbarimin e vendimit të dhënë në procedurën administrative dhe për kundërvajtje me të cilin është caktuar detyrimi në të holla, përveçse kur për përmbarimin e tillë është paraparë me ligj kompetenca e organit tjetër.*

#### *Neni 24 [Titujt Ekzekutiv]*

24.1 *Titujt ekzekutiv janë:*

- a) *vendimi ekzekutiv i gjykatës dhe ujdia gjyqësore ekzekutive;*
- b) *vendimi ekzekutiv i dhënë në procedure administrative dhe ujdia administrative, po qe se ka të bëjë me detyrimin në të holla dhe po qe se me ligj nuk është parapare diçka tjetër;*

- c) dokument noterial ekzekutiv;
- d) dokument tjetër që me ligj është quajtur dokument ekzekutiv.

*Neni 26 [Përmbarueshmëria e vendimit]*

1. Vendimi i dhënë në procedure administrative është përmbarimorë, po që se i tillë është bërë sipas rregullave me te cilat është rregulluar procedura e tillë.

*Neni 294 [Shpërblimi i pagës në rast të kthimit të punëtorit në punë]*

2. Propozuesi i përmbarimit që e ka parashtruar propozimin për kthim në punë, ka të drejtë të kërkojë që gjykata të nxjerrë aktvendim me të cilin do të caktojë se, debitori ka për detyrë që atij t'ia paguajë në emër të pagës shumë mujore që janë bërë të kërkueshme, nga dita në të cilën ka marrë formë të prerë vendimi e deri në ditën e rikthimit në punë. Me të njëjtin aktvendim, gjykata e cakton përmbarimin për realizimin e shumëve mujore të caktuara.

**Ligji Nr. 03/L-192 KPMSHCK**

*Neni 13 [Vendimi i Këshillit]*

Vendimi i Këshillit paraqet vendimin administrativ të formës së prerë dhe ekzekutohet nga zyrtaret të nivelit të lartë drejtues ose personi përgjegjës i institucionit që e ka marrë vendimin e parë ndaj palës. Ekzekutimi duhet të bëhet brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e pranimit të vendimit.

*Neni 14 [E drejta e ankesës]*

Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të inicioj konflikt administrative në gjykatën kompetente, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e vendimit të Këshillit.

*Neni 15 [Procedura në rast mos zbatimi të vendimit të këshillit]*

1. Moszbatimi i vendimit të Këshillit nga personi përgjegjës i institucionit paraqet shkelje të rëndë të detyrave të punës sipas ligjit për Shërbimin Civil në Republikën e Kosovës.
2. Nëse personi përgjegjës i institucionit nuk e ekzekuton vendimin e Këshillit në afatin e paraparë me nenin 13 të këtij ligji, Këshilli në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh, nga dita kur ka kaluar afati për ekzekutim, duhet të njoftoj me shkrim kryeministrin, dhe eprorin e drejtpërdrejt të personit përgjegjës për ekzekutim.
3. Njoftimi nga paragrafi 2. i këtij neni konsiderohet kërkesë për fillimin e procedurës disiplinore dhe materiale kundër personit përgjegjës për ekzekutim, e cila zhvillohet në pajtim me dispozitat e parapara Ligjin për shërbimin civil të Republikës së Kosovës.
4. Brenda afatit prej tridhjetë (30) ditëve nga dita e kalimit të afatit për ekzekutim, pala mund të filloj procedurën e ekzekutimit në gjykatën komunale sipas ligjit për procedurën përmbaruese kundër personit dhe institucionit përgjegjës për ekzekutim, për dëmet materiale dhe jo materiale që janë shkaktuar me këtë vendim. Nëse gjykata kompetente vendos që punëtori (personi), i cili e ka kontestuar këtë mosekzekutim (mosekzekutimin e vendimit), t'ia kompensoi shumë e pagave, shpenzimet procedurale dhe shpenzimet tjera të mundshme, personi përgjegjës i institucionit mban edhe përgjegjësi materiale për dëmin që ia ka shkaktuar institucionit sipas ligjit.

## **Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës**

31. Në mënyrë që të jetë në gjendje të gjykojë për kërkesën e parashtruesit, Gjykata duhet që së pari të vlerësojë nëse parashtruesi i kërkesës i ka plotësuar kërkesat e parapara me Kushtetutë, siç specifikohen më tutje në Ligj dhe Rregullore të punës të Gjykatës.
32. Gjykata, së pari duhet të përcaktojë nëse Parashtruesi është palë e autorizuar, që në pajtim me kërkesat e nenit 113.7 të Kushtetutës të parashtrorë kërkesë në Gjykatë. Parashtruesi, është person fizik dhe është palë e autorizuar në përputhje me kërkesat e nenin 113.7 (Kërkesat Individuale) të Kushtetutës.
33. Gjithashtu, parashtruesi duhet të provojë që i ka përmbushur kërkesat e nenit 49 të Ligjit, sa i përket dorëzimit të kërkesës brenda afatit ligjor. Nga shkresat e lëndës vërehet qartë se vendimi përfundimtar për rastin e parashtruesit është Aktvendimi i Gjykatës së Qarkut në Pejë nr. Ac. nr. 158/2011 i 5 korrikut 2011, të cilin parashtruesi e ka pranuar më 20 gusht 2011. Parashtruesi kërkesën e tij në Gjykatë e dorëzoi më 10 tetor 2011, që nënkupton se kërkesa është parashtruar brenda afatit 4 mujor të paraparë me ligj.
34. Gjykata, po ashtu, përcakton nëse parashtruesi ka provuar t'i ketë përmbushur kërkesat e nenit 47.2 të Ligjit. Duke qenë se parashtruesi fillimisht ka shterur mjetet juridike brenda institucionit të punësimit, ka vazhduar më tej kërkesën për realizimin e të drejtës në KPMSHCK, vendimi i të cilit është i formës së prerë në procedurë administrative, parashtruesi gjithnjë në kërkim të zbatimit të vendimit të KPMSHCK. ka shfrytëzuar edhe mjetin e fundit juridik në procedurën përmbartimore, që në rastin konkret është aktvendimi Ac. nr. 158/2011 i Gjykatës së Qarkut në Pejë, ndaj të cilit nuk lejohet ushtrimi i të drejtës për ankesë. Si rezultat, sipas ligjeve në fuqi parashtruesi ka shterur të gjitha mjetet juridike në dispozicion.
35. Gjithashtu, Gjykata përcakton nëse parashtruesi në kërkesën e tij ka saktësuar dhe qartësuar se cilat të drejta dhe liri pretendon t'i jenë shkelur, më cilin akt dhe nga cili autoritet publik. Parashtruesi, ka përmbushur edhe këtë kriter duke përmendur shkeljet e të drejtave të tij të garantuara me Kushtetutë dhe gjithashtu autoritetin publik që e konsideron shkelësin e këtyre të drejtave.
36. Gjykata konstaton se parashtruesi ka përmbushur të gjitha kriteret për pranueshmëri, pasi që ai është palë e autorizuar, ka përmbushur afatin e nevojshëm për parashtrimin e kërkesës në Gjykatë, ka shterur të gjitha mjetet juridike në dispozicion, dhe ka saktësuar me përpikëri pohimet e shkeljes së të drejtave dhe lirive, përfshirë edhe autoritetin publik që ka bërë shkelje.

## **Vlerësimi kushtetues i kërkesës**

37. Përderisa parashtruesi, ka plotësuar kriteret procedurale për pranueshmëri, Gjykata duhet ta shqyrtojë themelësinë e kërkesës së parashtruar në baza meritore.
38. Gjykata Kushtetuese, nga parashtruesit, vëren se parashtruesi i kërkesës nuk konteston asnjë vendim të autoriteteve publike a të gjykatave, sepse të gjitha vendimet janë në favorin e tij, duke filluar nga vendimi i KPMSHCK, aktvendimet e Gjykatës komunale në Klinë E. nr. 635/2010 i 18 nëntorit 2010 dhe E.nr.635/2010, i 7 prillit 2011, si dhe aktvendimi i Gjykatës së Qarkut në Pejë Ac. nr. 158/2011 i 5 korrikut 2011, që konsiderohet mjet i fundit juridik në procedurën përmbartimore. Kërkesa e parashtruesit ka të bëjë me moszbatimin e vendimit të KPMSHCK dhe të vendimeve gjyqësore nga ana e autoriteteve të Komunës së Klinës.

39. Duket qartë se, parashtruesi i kërkesës i ka konsumuar të gjitha rrugët ligjore dhe institucionale në kuptim të zbatimit të vendimeve të zhvilluara në procedurën administrative dhe në procedurën e rregullt gjyqësore. Mirëpo, edhe përkundër përpjekjeve të shumta të parashtruesit në kërkim të realizimit të së drejtës së fituar me vendimet e lartpërmendura për kthim në punë, përpjekjet e tij nuk janë marrë seriozisht nga autoritetet e Komunës në Klinë.
40. Prandaj, mosndërmarrja e veprimeve konkrete ligjore për zbatimin e një vendimi përfundimtar, të formës së prerë, lë për të kuptuar që kjo Komunë ka dështuar të provojë se është e gatshme t'i respektojë vendimet gjyqësore. Moszbatimi i vendimeve gjyqësore nga Komunitat është në kundërshtim të plotë me kërkesat e nenit 124.6 të Kushtetutës, që qartazi citon se:
- “Komunitat obligohen të respektojnë Kushtetutën, ligjet, dhe të zbatojnë vendimet gjyqësore”.*
41. Është obligim Kushtetues, që Komunitat e Republikës së Kosovës, t'i respektojnë dhe zbatojnë vendimet gjyqësore, e jo t'i zvarrisin procedurat e përmbarimit të tyre me arsyetime të pa qëndrueshme dhe të pa bazuara ligjërisht. Arsyetimi i autoriteteve të Komunës për iniciimin e konfliktit administrativ nuk duhet të ishte pretekst për moszbatimin e vendimit përfundimtar të KPMSHCK të zhvilluar në procedurë të rregullt administrative, në pajtim me ligjin përkatës që i parasheh dhe rregullon në mënyrë të qartë procedurat e tilla (*shih:nenin 14 të Ligjit Nr. 03/L-192 për KPMSHCK, [.. ] “Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e vendimit të Këshillit”*).
42. Gjykata Kushtetuese, sa i përket qartësisht të pozicionit dhe juridiksionit të KPMSHCK, konsideron që, KPMSHCK është institucion i pavarur i konstituuar me ligj, në pajtim me Kushtetutën (shih, nenin 101.2 të Kushtetutës). Prandaj, të gjitha obligimet që dalin nga ky institucion lidhur me çështjet që janë nën juridiksionin e këtij institucioni prodhojnë efekte juridike për institucionet e tjera përkatëse, ku statusi i të punësuarve është i rregulluar me Ligjin për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës. Vendimi i këtij institucioni paraqet vendim administrativ të formës së prerë dhe si i tillë duhet të përmbarohet nga gjykata kompetente sipas propozimit për përmbarim nga kreditori në kuptim të realizimit të së drejtës së fituar në procedurë administrative.
43. Neni 6 i Konventës, zbatohet edhe për fazat administrative të procesit gjyqësor gjegjësisht është brenda kornizave “për të drejtën në gjykim të drejtë dhe të paanshëm” e drejtë kjo e garantuar edhe me nenin 31 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës. Nga kjo rrjedh se edhe moszbatimi i vendimeve të Këshillit është element i nenit 6 të Konventës dhe shkelje e saj.
44. Për më tepër, Gjykata i referohet nenit 54 të Kushtetutës që nënvizon faktin se, *“Çdokush gëzon të drejtën e mbrojtjes gjyqësore në rast të shkeljes ose mohimit të ndonjë të drejte të garantuar me këtë Kushtetutë ose me ligj, si dhe të drejtën në mjete efektive ligjore nëse konstatohet se një e drejtë e tillë është shkelur”*.
45. Gjykata, thekson se, është e drejtë e palës së pakënaqur që të iniciojë procedurë gjyqësore në rast të dështimit të realizimit të së drejtës së fituar që parashihet me nenin 31 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, si dhe nenin 6 në lidhje me nenin 13 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ). Do të ishte e pakuptimtë, nëse sistemi ligjor i Republikës së Kosovës do të lejonte që një vendim gjyqësor përfundimtar, i formës së prerë, të mbetej i paefektshëm në dëm të një pale. Interpretimi i neneve të lartpërmendura në mënyrë ekskluzive ka të bëjë me qasjen ndaj gjykatës. Prandaj, joefektshmëria e procedurave dhe moszbatimi i vendimeve



prodhojnë efekte të cilat na sjellin para situatave që nuk janë në përputhje me parimin e sundimit të ligjit, parim të cilin autoritetet e Kosovës janë të obliguara ta respektojnë (shih: vendimin e GJEDNJ-së në rastin Romashov kundër Ukrainës, Parashtrës nr. 67534/01, aktgjykimi i 25 korrikut 2004).

46. Gjykata është e mendimit se, ekzekutimi i një vendimi të marrë nga një gjykatë duhet shikuar si pjesë përbërëse e të drejtës për gjykim të drejtë, e drejtë kjo e garantuar me nenet e lartpërmendura (shih: rastin Hornsby kundër Greqisë, aktgjykimi i 19 marsit 1997, raportet 1997-II, f 510, para. 40). Në rastin konkret, parashtruesi nuk do të duhej privuar nga përfitimi i vendimit të formës së prerë, që është në favorin e tij. Asnjë autoritet nuk mund të arsyetojë moszbatimin e vendimeve për qëllim të fitimit të rishikimit dhe rishqyrtimit të freskët të rastit (shih: Sovtransavto Holding kundër Ukrainës, nr. 48553/99, § 72, ECHR 2002-VII, si dhe Ryabykh kundër Rosisë, nr. 52854/99, § 52, ECHR 2003-IX). Autoritetet kompetente, pra, kanë për obligim që të organizojnë një sistem efikas për zbatimin e vendimeve, që janë efektive në kuptimin ligjor dhe atë praktik, si dhe duhet të sigurojnë zbatimin e tyre në kohë të arsyeshme, pa vonesa të panevojshme (shih: Pecevi kundër Ish-Republikës Jugosllave të Maqedonisë, nr. 21839/03, 6 nëntor 2008; Martinovska kundër Ish-Republikës Jugosllave të Maqedonisë, nr. 22731/02, 25 shtator 2006).
47. Si përfundim, Gjykatë Kushtetuese konstaton se, moszbatimin e vendimeve gjyqësore nga autoritetet e Komunës dhe dështimi i autoriteteve kompetente të Republikës së Kosovës për të siguruar mekanizma efikas në kuptim të zbatimit të vendimeve të autoriteteve përkatëse dhe vendimeve gjyqësore përbenë shkelje të Nenit 31, 32 dhe 54 të Kushtetutës, si dhe Nenit 6 në lidhje me nenin 13 të KEDNJ-së.
48. Duke dështuar të zbatojë Vendimin e KPMSHCK të 8 tetorit 2010, autoritetet përkatëse kanë privuar dispozitat e nenit 54 të Kushtetutës dhe nenit 13 të KEDNJ nga të gjitha efektet e dobishme.
49. Neni 13 i KEDNJ përcakton:

“Çdokush, të cilit i janë shkelur të drejtat dhe liritë e përcaktuara në këtë Konventë, ka të drejtën e një zgjidhjeje efektive para një organi kombëtar, pavarësisht se shkelja është kryer nga persona që veprojnë në përmbushje të funksioneve të tyre zyrtare.”
50. Në këto rrethana, Gjykata konsideron se është shkelur e drejta në gjykim të drejtë dhe efektive, që garantohet me nenet e përmendura të Kushtetutës dhe KEDNJ, dhe se Vendimi përfundimtar përmbartimor i KPMSHCK, Vendimi nr. 02/197/2010 i 8 tetorit 2010 dhe Vendimi Ac. nr. 158/2011 i Gjykatës së Qarkut në Pejë, i 5 korrikut 2011 duhet të ekzekutohen.


## PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 20 të Ligjit, dhe Rregullin 56 (1) të Rregullores së Punës, në seancën e mbajtur më 11 korrik 2012, njëzëri

### VENDOSI

- I. TA SHPALLË kërkesën të pranueshme;
- II. Se ka pasur shkelje të nenit 31, 32 dhe 54 të Kushtetutës dhe nenit 6 dhe 13 të KEDNJ;
- III. Se vendimi përfundimtar dhe përmbarimor i KPM, Vendimi nr. 02/197/2010 i 8 tetorit 2010, dhe Vendimi Ac. Nr. 158/2011 i Gjykatës së Qarkut në Pejë, i 5 korrikut 2011, duhet të ekzekutohen nga organi kompetent, në veçanti, nga Komuna e Klinës;
- IV. Në pajtim me Rregullin 63 (5) të Rregullores së Punës, Komuna e Klinës duhet t'i dorëzojë Gjykatës Kushtetuese informata lidhur me masat e ndërmarra për të zbatuar këtë Aktgjykim të Gjykatës Kushtetuese;
- V. Ky Aktgjykim do t'u komunikohet palëve dhe do të botohet në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese; dhe
- VI. Ky Aktgjykim hyn në fuqi menjëherë.


**Gjyqtar raportues**



Altay Suroy



**Kryetar i Gjykatës Kushtetuese**



Prof. Dr. Enver Hasani